

LIGJ
Nr.7642, datë 1.12.1992

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7552, DATË 22.1.1992 "PËR DISA NDRYSHIME NË
LIGJIN NR.4976, DATË 29.6.1972 "PËR PENSIONET E ANËTARËVE TË
KOOPERATIVAVE BUJQËSORE"**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7552, datë 22.1.1992 "Për disa ndryshime në ligjin nr.4976, datë 29.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore", neni 5 ndryshohet si vijon:

"Pensioni minimal i ish-anëtarëve të kooperativave bujqësore fushore e kodrinore qëndron në nivelin e pensionit minimal, që ata merrnin deri në datën 31.10.1992.

Pensioni i ish-anëtarëve të kooperativave bujqësore malore që banojnë në këto zona rritet 10 për qind në krahasim me pensionin që ata merrni deri në datën 31.10.1992.

Me krijimin e mundësive financiare Këshilli i Ministrave vendos rritjen e pensioneve të pleqërisë dhe invaliditetit të ish- anëtarëve të kooperativave bujqësore".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.388, datë 9.12.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.